Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

b. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2016 dhe 2017 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifat vendore).

Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit të plotësuar më sipër

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

Vlerësimi i gjendjes ekonomike e financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme :

- 1. Kopje të vërtetuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse; (për dy vitet e fundit 2016 dhe 2017)**
- 2. Xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit (2015-2016-2017) duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit që prokurohet, e konfirmuar në mënyrë elektronike për secilin prej Loteve për të cilat ofertuesi konkuron.**
- 3. Operatori ekonomik të ketë të punësuar minimumi 2 (dy) punonjës të siguruar vërtetuar kjo me vërtetim Formulari E-SIG 02/a nga sigurimet shoqërore për periudhën janar –tetor 2018, e konfirmuar në mënyrë elektronike.**

2.3 Kapaciteti teknik:

kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale :

1. Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a. Furnizime të së njëjtës natyrë (furnizim me artikuj ushqimorë – sipas lotit) me vlerë e cila nuk duhet të jete me e vogël se 40 % e fondit limit të lotit të ushqimeve/Loteve për të cilat ofertuesi konkuron.**

➤ **Kerkohen të paraqiten kontrata të ngjashme, të realizuara në 3 vitet e**

fundit (viti, 2015 - 2016 – 2017) dhe vërtetim për realizimin me sukses të tyre.

- **Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik.**

- 2. Liçensa profesionale lidhur me mallrat objekt i kontratës që prokurohet , Licence e leshuar nga Organet tatimore për tregëti me shumicë ose me pakicë të artikujve ushqimorë.**
- 3. Operatori ekonomik të jetë i pajisur me Certificate të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimorë ISO 22000, ose ekuivalente me to.**
- 4. Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumenta se ka në pronësi (certificate pronësie) ose në përdorim (kontratë noteriale të objektit që ka me qira) një njësi tregëtare në qytetin e Sarandës për magazinimin dhe përgatitjen e mallrave gjatë gjithë periudhës të zbatimit të kontratës të mallit për vetë natyrën e mallrave që prishen dhe duhen të freskëta**
- 5. Operatorët ekonomikë duhet të kërkojnë Licence leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për objektin e prokurimit të lotit që konkuron.**
- 6. Operatori ekonomik duhet të provojë disponueshmërinë me të gjitha format e njohura nga legjislacioni përkatës në fuqi, për 1 (një) automjet të përshtatshëm të specializuar sipas natyrës së mallrave që do transportohet me kushte higjienike .Për të vërtetuar këtë kriter operatori ekonomik duhet të paraqesë:**
 - **Për automjetin në pronësi: akt pronësie (kontrata/fatura shitblerje ose kontrata dhurimi), leje qarkullimi, akt kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.**
 - **Për automjetet që nuk janë në pronësi: kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht 12 muaj, leje qarkullimi, akt kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.**
- 7. Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimorë.Për këtë ai duhet të paraqesë vetëdeklarim ,ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.**

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Te gjitha mallrat ushqimorë të jenë brenda parametrave dhe standarteve të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit si më poshtë:

Loti 1 – Ushqime koloniale

Orizi të jete me treguesit shqisor: Pamja kokrra të shendosha, të plota, të pastra e pa myk. Ngjyra e bardhë. Era pa shije të thartë pa erë myku. Treguesit fiziko – kimik: lageshtira deri në 15 %, kokrra të thyera deri në 12%, lende të huaja deri në 0.4 %, kokrra të verdha deri në 4%. Nuk lejohen demtues. Amballazhi në pako 1 kg, letre ose plastmasë ose në thasë lini ose plastmasë 50 kg.

Makaronat të jenë me treguesit shqisor: ngjyra e bardhë në të verdhë, pa shije të hidhur e të thartë, pa erë të huaj. Treguesit fiziko – kimik: lageshtira deri në 13 %, aciditeti jo më shumë se 0.16 %, rritja e volumit jo më pak se dy herë. Nuk lejohen demtues. Mielli i stazhionuar jo më pak se 15 ditë, i siguruar 100%, nuk lejohen demtues. Amballazhi: në pako 0.5 ose 1 kg, i etiketuar sipas standartit dhe të futura në kuti kartoni.

Public Health Sector

Vaji ushqimor të jete sipas standart shtetëror 203: 2003. Treguesit fiziko-kimik: Dendësia relative në 20 grade.C/ uje në 20 grde.C 0.918-0.923. Numri i refraksionit 1.461-1.468. Numri i sapunifikimit 188-194. Treguesi i jodit 118-141. Treguesi i cilesise: Ngjyra e verdhë në të lehtë. Era dhe shija karakteristike e vajit të lulediellit, pa erë e shije të huaj. Numri i peroksideve: Jo më shumë se 10 mek O₂ aktiv / kg vaj. Numri i aciditetit: jo më shumë se 0.4 mg KOH gr vaj. Shmangia në vëllim deri në 1%. Kontaminuesit jo më shumë se : lende të patretshme 0.05%. Permbajtja e sapuneve 0.005%. Lende fluturuese, në 105 grade c 0.2. Amballazhi dhe etiketimi: Amballazhi bëhet në shishe plastike me kapacitet 1 liter. Mbi çdo amballazh **vendoset etiketa për datën e prodhimit, llojin e vajit, masën në litra, etj.** **Etiketimi bëhet sipas legjislacionit në fuqi.**

Sheqeri duhet të jete me treguesit fiziko-kimik: Sheqer i paster 99.6%, hiri deri 0.07%, lageshtira deri në 0.16 %. Pamja: pluhur i perbere nga kristale të imta e të njellojta. Ngjyra: e bardhë në shkëlqim. Treguesit shqisor: i derdhur i thatë, me shije të embël pa erë të huaj, përdorim të njëtrajtshëm, të tretët plotësisht. Amballazhi në pako letre 1 kg ose thasë lini ose plastmasë 50 kg dhe etiketuar sipas standartit në fuqi.

Kripa duhet të jete e cilesise se pare e jodizuar, e amballazhuar në pako 0.5 deri 1

kg. Pamja: mase e perhedhur dhe e perbere nga kristale te imta e te njellojta. Ngjyra: e bardhe me shkelqim. Treguesit shqisor: me shije karakteristike te kripur, pa ere te huaj, me perdorim te njetrajtshem, e treteshme plotesisht ne uje.

Salca duhet te jete e perpunuar me baze vetem domate, prodhim vendi ose i huaj. Malli te jete i amballazhuar ne kuti llamarine ose qelqi 500 gr. Kutia te jete e mbyllur hermetikisht dhe e mbeshjtjelle me etikete te perkthyer ne gjuhen shqipe kur malli eshte i huaj. Permbajtja te jete salce dhe kripe. Perberja e mases te jete homogjene dhe me 18 -20 % lende e thate. Nuk lejohen perberes te tjere dhe lende te huaja. Ngjyra e salces te jete e kuqe e thelle. Shija te jete e embel pa shume aciditet. Aroma te jete e kendeshme ne perputhje me aroren e domates se fresket karakteristike e llojit. Ne etikete te jete shenuar qarte firma prodhuese dhe ajo tregtuese. Kapaku te jete i mbyllur hermetikisht dhe me afatin e skadences. Nuk lejohet me afat perdorimi me shume se nje vit.

Recel frutash (jo fiku), kokerr, i amballazhuar me ene hermetike dhe pa papasterti, duhet te jene sipas standartit shteteror te amballazhuara ne vazo 450 gr. me etiketim te rregullt ku te lexohet qarte prodhuesi, data e prodhimit, skadencia ku afati i skadences te jete mbi 9 muaj nga data e furnizimit, si dhe pambajtja e tyre.

Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit.

Loti 2 – Veze , perime e fruta

Qumeshti

duhet te jete brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te jete prodhuar brenda dites mundesisht nga mjelja e pare ne mengjes pasi dhe konsumi do te jete ditor. Qumeshti te kete karakteritikat tipike te qumeshtit i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17 – 19, ngarkesa mikrobike 1 – 2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10 – 12. Transporti do te kryhet ne ene plastike te standartit shteteror. Qumeshti duhet te jete i prodhuar e grumbulluar brenda kushteve standarte higjenike te Ministrise se Bujqesise dhe Ministrise se Shendetsise. Furnizimi do te jete ditor sipas kerkeseve te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Sarande dhe ne funksion te nevojave te saj.

Prodhimi te jete i shoqeruar me **certifikate te analizes te bere nga laboratorit veterinar.**

Furnizimi do te kryhet sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri ne magazinat e bleresit nga ora 07⁰⁰ – 08⁰⁰.

Vezet

duhet te jene sipas standartit shteteror 4N/ECE 42 te vitit 2001. Vezet te jene prodhim **vendi dhe te stampuara ku te dallohet qarte origjina e mallit.** Te jene te vendosura ne bikurina, te amballazhuara ne kuti kartoni ku te jete etiketuar prodhuesi, data e prodhimit dhe te jene te vulosura nga prodhuesi mbi cdo kuti.

Vezet duhet të kenë një afat skandence nga data e prodhimit vetëm 15 ditë. Të jenë me peshë 50 deri 70 gr për koker.

Perimet :

Bamja: Kerkohen të jenë të fresketa, të shendosha, të pastra, me fije normale për kultivarin dhe fara që duket lehtë, me formë të drejtë, lehtësisht të deformuar. Forma të jete e një prizmi shumëkëndesh që ngushtohet në majë, **te pa drunjezuara e pa fije**. Gjatesia e cilesisë së pare për bamjen frutshkurter të jete deri në 6 cm dhe për atë frutgjatë të jete deri në 8 cm. Lejohet deri në 5 % të partisë me vyshkje të lehtë. Nuk lejohet me semundje e demtues. Ngjyra të jete tipike për kultivarin. Fruti të jete i butë, me fara të vogla në fazën e qumeshtit. Lejohet me fruta të tejpyjekura deri në masën 2% për cilesinë e pare.

Domate : Kerkohet domate e cilesisë së pare, të jenë të fresketa, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pa vrara, të pa shtypura, pa kalbje dhe pa njolla nga dielia e diellit, të pa prekur nga semundjet dhe demtuesit si dhe të pa lagura. Pjekuria duhet të jete normale, me ngjyrë të kuqe, lehtësisht rozë dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpyjekura, të zbutura e të vyshkura. Demtime e semundje nuk lejohen. Të plasura e të vrara lehtësisht për llojet e mësimë e të vona lejohet deri në 5 % plasaritje rreth bishtit, por pa rrjedhje lëngu. Madhësia e kokrres të jete :Për të hershmet 3-4 cm. Për të mësimet e të vonat 7 cm.

Patellxhan : kerkohet cilesia e pare, të jenë të fresket, të paster, me sipërfaqje të lëmuar, me ngjyrë të zeze në manushaqe, me pjekuri normale, me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura. Demtime të ndryshme e semundje nuk lejohen. Për të gjatët kerkohet diametri jo më shumë se 5 cm dhe gjatesia 15-20 cm. Gjatesia e bishtit të jete jo më shumë se 4 cm.

Qepe e hudhra të njome : Kerkohen cilesia e pare, të jenë të njoma, të fresketa, të pastra, të lara me ujë të pijshëm, me ngjyrë jeshile të gjetheve, e pa çara, të pa vyshkura e pa karabush. Diametri i kercellit të jete mbi 1.5 cm. Gjatesia e tufës të jete pa kufizim dhe me bishta të pa prera. Sistemi rrenjor të jete deri në 1 cm. Demtime mekanike nuk lejohen.

Gjethe të verdha e të lagura, karabushe të mëdhenj, të gjatë e të kalbur nuk lejohen.

Qepe e thate : Kerkohet cilesia e pare, të jete me pjekuri të plote, me cipe e bisht të thate, të shendosha e të plota, me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm. Madhësia e kokrres për ovalet të jete nga 48 cm dhe për llojet e tjera 5-10 cm. Lejohen jo më shumë se 1 % e partisë me demtime të lehta dhe 1 % lende të huaja. Me semundje nuk lejohen. Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Speci : Kerkohet cilesia e pare, të jenë me formë e ngjyrë të kultivarit, të fresketa, të pastra dhe me pjekuri natyrale. Lejohen demtime jo më shumë se 3 %. Shija të jete karakteristike e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet perzierja e specave djegës me ato jo djegës. Gjatesia të jete për të gjatat mbi 10 cm dhe për të rrumbullaktat mbi 7 cm.

Lakra : Kerkohet cilesia e pare, të jenë të zhvilluara, me mbështjellje fletësh, e fortë në prekje. Lejohen lakra të pa ngjeshura deri në 5 % të partisë. Të jenë të pastra dhe me 2-3 gjethe të gjelbera, të lidhura me koçanin i cili të jete deri në 2.5 cm. Lejohen deri në 5 % e partisë me demtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shpërthyer si dhe të demtuara lehtësisht nga bryma. Me semundje nuk lejohen. Pësia e kokrres të jete jo më pak se 1 kg për lakrën e hershme dhe për prekje të

mesme e të vona jo më pak se 1.5 kg.

Preshi : Kerkohet cilesia e pare, të jete i fresket, i njome, i paster, me gjyre të bardhe e jeshile, i pa vyshkur dhe i lare me uje të pijshem. Diametri në pjesen më të trashë të jete mbi 2.5-3.5 cm. Gjatesia e kercellit të jete 25-45 cm. Gjatesia e gjethit nga rozeta të jete jo më shumë se 20 cm. Sistemi rrenjor të jete jo më shumë se 0.5 cm. Demtime dhe semundje nuk lejohen.

Spinaq : Kerkohet cilesi e pare, i fresket , i njome, i paster me ngjyre jeshile të erret, i pa vyshkur dhe i lare me uje të paster, i lidhur në dengje të vogla deri në një kg. Me rrenje të prera, gjatesia e kercellit të mos jete më shumë se 5 cm, të mos kete prani të barerave të tjera, gjethet të jene të plota me gjerësi deri në 10 cm dhe gjatesi e gjethes deri në 20 cm., gjethet të jene pa njolla të ngjyres së ndryshkut, pa demtime nga krimbat, pa demtime mekanike, të fresketa dhe të pavyskuara.

Patate : Kerkohet cilesia e pare, të jete e plote, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyre dhe me sytha tipike të kultivarit. Kokrra të jete e pjekur. Madhësia e kokrrës të jete për patatën dimerore mbi 5 cm dhe për ato verore mbi 4 cm. Nuk lejohen të gjelbera, të vyshkura, të mbira, të çara e të prera, të kalbura, zgjebe në plage, njolla boje hiri e ndryshku, demtime nga krimbi, demtime nga dosha dhe të papastruara nga dherat. Duhet të jene të ambalazuara në thase rrjete 25 deri në 30 kg.etj.

Frutat:

Dardha : Kerkohet cilesia e pare, me zhvillim normal, të shendosha, me ngjyre karakteristike të kultivarit, me pjekuri teknike dhe me bisht. Madhësia e kokrrës në mm të jete jo më pak se 45 për dardhat e rrumbullakta dhe 40 mm për ato të gjata. Demtime mekanike, lejohen deri në 5 % të partise së mallit. Nuk lejohet të jene më semundje. Demtime nga bryma, ngrica, të lagura dhe lende të huaja nuk lejohen.

Molla : Kerkohet cilesia e pare, me forme, ngjyre e shije të kultivarit, pa deformime, me pjekuri teknike të njejte, të shendosha, të pastra, të zhvilluara normalisht, pa ere e shije të huaja. Lejohen edhe kokrra pa bisht, por pa defekte rreth bishtit. Madhësia e kokrrës të jete jo më pak se 60 mm në prerje në gjatësi. Demtime të ndryshme mekanike lejohen deri në dy njolla jo të zeza, të vogla, të lehta për kokërr. Nuk lejohen të krimbura. Njolla të shkaktuara nga dielli në lekurenuk lejohen. Gunga, njolla në lekure nuk lejohen. Njolla nga solucionet kimike në sipërfaqen e kokrrës lejohet deri në ¼ e sipërfaqes së frutit.

Rrush : Kerkohet cilesi e pare, veshuli me dendësi tipike të kultivarit. Lejohen veshul të vegjel që përmbajnë jo më pak se 10 kokrra, por të mos kalojnë 5 % të partise. Kokrrat të jene të fresketa me zhvillim normal, pjekuri të plote, me cilesi të shendoshe e të paster. Nuk lejohen demtime mekanike dhe kokrra të skuqura. Përmbajtja e sheqerit të jete 14-16 sipas llojit të varietetit. Nuk lejohen lende të huaja. Nuk lejohen kokrra të mykura e të kalbura, të fermentuara dhe të thara.

Pjeshka : Kerkohet cilesia e pare, kokrra të jete e fresket, me zhvillim normal, me ngjyre karakteristike të kultivarit, të pasterta, pa bishta, me shije të embel dhe ere karakteristike të kultivarit. Të jete me pjekuri të plote teknike. Madhësia e kokrrës të jete për të hershmet deri në 50 mm, gjysem të hershme deri në 55 mm dhe të vonshme deri në 60 mm. Demtime të lehta mekanike nuk lejohen. Demtime nga semundjet, insektet, dielli, ndryshim ngjyre të jete jo më shumë se 5 %. Nuk lejohen të mykura, të fermentuara, të kalbura dhe lende të huaja.

Portokalli : Kerkohet cilesi e pare, i fresket, me zhvillim normal, të shendoshe e me bisht. Për dhe mbas 15 janarit lejohet kokrra pa bisht, përkatësisht 5 & 20 %, me

pjekuri teknike të plote. Ngjyra të jetë karakteristike e kultivarit, e verdhe në portokalli, me ere karakteristike dhe shije të embël në të atë, pa shije të hidhur. Madhësia e kokrës të jetë jo më pak se 70 mm. Demtime mekanike nuk lejohen. Të prekura nga semundjet dhe insektet nuk lejohen. Lende të huaja nuk lejohen. Gërvishje në sipërfaqe por pa prekur tulin, nuk lejohen. Zbutje të kokrrave, ngrirje dhe lagje të sipërfaqes së tyre nuk lejohen.

Loti 3- mish pule ,djathë fete.

Mishi i pulës (kofshë pulë)

Mishi i pulës (kofshët e pulës) çdo copë duhet të jetë jo më shumë se 150 gr, të jenë në brendë standarteve shtetërore dhe i certifikuar për konsum. Me ere të këndshme, karakteristike të llojit. Pamja e jashtëme të jetë me sipërfaqja karakteristike të mishit të pulës dhe me ngjyrën karakteristike të tij.

Çdo parti mishi shoqërohet me **certifikatën veterinare dhe të cilesisë**, me të cilën vërtëtohet gjendja e tij e mirë shëndetsore për shitje në treg (për konsum).

Furnizimi do të kryhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, me mjetet e furnitorit deri në magazinat e blerësit.

Djathë fete

Kërkohet me bazë prodhim nënprodukt i qumështit të lopës, deles, ose dhise. **Nuk lejohet prodhim i djathit me përzierje qumësht pluhur ose të kodensuar**. Ngjyra të jetë sipas llojit të qumështit , djathë lope, në ngjyrë të qumështit (krem), i deles dhe dhise të ketë ngjyrën karakteristike të qumështit të bardhë (**kur djathë është prodhuar me bazë qumështi delje ose dhie, dhe ngjyrë kremi kur djathë është prodhuar nga qumështi i lopës**)

Përqindja e yndyrës të jetë jo më shumë se 3 %. Pamja e jashtëme të jetë konforme, në brendësi poroze karakteristike të djathit të stazhionuar mirë. Sasia e kripës të jetë normale. Shija të jetë e mirë karakteristike e djathit normal pa erëra të tjera jo të këndshme. Ambalazhimi të jetë i shoqëruar hire deri 10 – 14 % kripe deti i mbyllur me kapak hermetik në mënyrë që të mos rrjedhë. Nuk lejohet furnizimi i djathit që ka afat skadence më pak se një vit. **Malli të jetë i shoqëruar me certifikatë të cilesisë dhe të standarteve të miratuara .**

Në etiketë të jetë shënuar data e prodhimit, data e stazhionimit dhe data e skadencës.

Loti 4 – Buke Gruri R 70

Bukë e grurit do të prodhohet me miell rreze 70 %, i stazhionuar për një periudhë prej 10-30 ditësh. Mielli duhet të jetë i freskët, me ngjyrë, erë , shije dhe lageshtirë konforme standarteve perkatese të miellit me rreze 70 %. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lende të huaj. Bukë duhet të ketë formë të drejtë dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukes duhet të jetë e lëmuar dhe pa plasje të ndryshme. Vëllimi i bukes duhet të jetë i mjeftueshëm. Shija, erë, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet të jetë konforme standartit teknik të prodhimit të saj. Korja e bukes – duhet të jetë e lëmuar, pa djegie, pa shkeputje të saj nga tulla, ngjyra e njellojtë, mjalti në të

kuqerremte, ne te gjithë siperfaqen. Tuli duhet te jete i pjekur mire, me porozitet te imet ne te gjithë vellimin e tij dhe nuk duhet te kete gjurme mielli te pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me ere te huaj, me shije te hidhur e te tharte, me lende te huaja, me lageshtire jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet ne forme katerkendeshe dhe me peshe 1(nje) kg, lageshtira jo me shume se 44.5 %, poroziteti jo me pak se 72%, aciditeti jo me shume se 45%. Furnizimi i bukes do te behet cdo dite prane magazinave te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Korce sipas kerkeses. **Amballazhi i transportimit te bukes duhet te jete i paster , te jete ne qese letre dhe te siguroje mos demtimin e saj.** Mjetet transportuese duhet te jene te pastra, te mbyllura qe te sigurohet transportim normal i bukes deri ne destinacionin perkates.

Loti 5 – Qumesht dhe kos

Duhet te jene brenda standarteve shteterore dhe i certifikuar per konsum. Qumeshti te jete i paterizuar dhe i ambalazhuar ne amballazh kartoni 1 lit. TE jene te dukshme data e prodhimit(amballazhimi), data e skadimit. Qumeshti te kete karakteritikat tipike te qumeshtit i cili ka ngjyre pak te verdhe, pa perberes te huaj dhe papasterti te tjera, i kulluar dhe me perqindje yndyre deri ne 2%, aciditet 17 – 19, ngarkesa mikrobike 1 – 2 milion / 1 ml, mbetja e thate 10 – 12. Furnizimi do te jete sipas kerkesave te Drejtorise se Sherbimit Spitalor Sarande dhe ne funksion te nevojave te saj.

Prodhimi te jete i shoqeruar me **certifikate te analizes te bere nga laborator i veterinar.**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Lot. 1 Ushqime koloniale 2019

Nr	EMERTIMI	NJ/M	Sasia	Grafiku
1	Sheqer	kg	300	Sipa kerkesave te AK
2	Oriz	kg	946	Sipa kerkesave te AK
3	Makarona	kg	650	Sipa kerkesave te AK
4	Vaj gjelle	litra	720	Sipa kerkesave te AK
5	Vaj ulliri	litra	30	Sipa kerkesave te AK
6	Miell	kg	50	Sipa kerkesave te AK
7	Niseshte	kg	12	Sipa kerkesave te AK
8	Recel 370 gr	cop	40	Sipa kerkesave te AK
9	Fast 250 gr	cop	40	Sipa kerkesave te AK
10	Uthull 420ml	cop	30	Sipa kerkesave te AK
11	Leng limoni 420ml	cop	30	Sipa kerkesave te AK
12	Piper I zi 100gr	cop	10	Sipa kerkesave te AK
13	Thjereza	kg	80	Sipa kerkesave te AK
14	Kripe	kg	130	Sipa kerkesave te AK
15	Caj (jo mali)	kg	4	Sipa kerkesave te AK
16	Salce	kg	110	Sipa kerkesave te AK

Lot. 2 Perime, fruta dhe veze 2019

Nr	EMERTIMI	NJ/M	Sasia	Grafiku
1	Veze	kokra	4400	Sipa kerkesave te AK
2	Patate	kg	1860	Çdo dy dite
3	Qepe te thata	kg	470	Çdo dy dite
4	Qepe te njoma	kg	120	Çdo dy dite
5	Spinaq	kg	240	Çdo dy dite
6	Bizele	kg	250	Çdo dy dite
7	Presh	kg	300	Çdo dy dite
8	Koke laker	kg	130	Çdo dy dite
9	Specat	kg	160	Çdo dy dite

Dokumentat standarde të tenderit “ **Furnizim me artikuj ushqimorë** “

10	Paterxhane	kg	230	Çdo dy dite
11	Kungull i njome	kg	160	Çdo dy dite
12	Bamje	kg	50	Çdo dy dite
13	Barbunja	kg	160	Çdo dy dite
14	Hudhra te thata	kg	20	Çdo dy dite
15	Karota	kg	70	Çdo dy dite
16	Domate	kg	160	Çdo dy dite
17	Ereza	kg	14	Çdo dy dite
18	Fruta	kg	26	Çdo dy dite
19	Rigon	cop	15	Çdo dy dite

Lot. 3 Mish,djath 2019

Nr	EMERTIMI	NJ/M	Sasia	Grafiku
1	Mish pule	kg	1650	Cdo jave
2	Djath fete	kg	820	Sipa kerkesave te AK

Lot 4 Buke gruri 2019

Nr	EMERTIMI	NJ/M	Sasia	Grafiku
1	Buke gruri 1 kg	cop	3315	Çdo dite

Lot. 5 Qumesht, Kos 2019

Nr	EMERTIMI	NJ/M	Sasia	Grafiku
1	Qumesht	litra	1900	Çdo dite
2	Kos	litra	3200	Çdo dite

Afatet e lëvrimit: **Nga data e lidhjes se kontrates per nje afat kohor prej 12 muaj (sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor – (AK))**

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumentat standarde të tenderit “ **Furnizim me artikuj ushqimorë** “

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [____]/është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[*Data*]

Për: [*Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues*]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj*]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat standarde të tenderit “ **Furnizim me artikuj ushqimorë** “

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokurara me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjatë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

Dokumentat standarde të tenderit “ **Furnizim me artikuj ushqimorë** “

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbeleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t’i përdorë për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
